



Deloitte.

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri

Përmbledhja e Raportit 2011 dhe 2012

Nëntor 2014

Përmbajtja

Çfarë është EITI?	5
Industria nxjerrëse në Shqipëri	6
Kontributi në ekonominë shqiptare	11
Rakordimi i të ardhurave dhe pagesave	14



Burimet natyrore i përkasin qytetarëve të një vendi. Qytetarët kanë të drejtë të informohen për mënyrën se si po i administron Shteti këto burime. Megjithatë, në shumë vende ky informacion nuk është i publik.

EITI bazohet në besimin se përdorimi i matur i burimeve natyrore sjell rritje ekonomike, zhvillim të qëndrueshëm dhe reduktim të varfërisë në vendet e pasura me burime natyrore.

Çfarë është EITI?

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ("NTIN" ose EITI") është një koalicion vullnetar ndërkombëtar i qeverive, shoqërive që operojnë në këtë industri dhe organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në administrimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore, të tilla si nafta, gazi dhe minerale të tjera. Nisma rregullohet nëpërmjet një standarti ndërkombëtar, "Standarti EITI".

EITI ka për qëllim promovimin e transparencës për të parandaluar korrupsionin, si dhe t'i sigurojë qytetarëve një bazë për të kërkuar përdorimin e drejtë të të ardhurave.

Kjo nisëm fillon një proces ku Shteti do të jap llogari para qytetarëve për përdorimin e këtyre të ardhurave.

Standarti EITI kërkon që shoqëritë publikojnë atë që paguajnë dhe shtetet publikojnë atë që arkëtojnë. Këto pagesa do të rakordohen nga një administrator i pavarur dhe do të paraqiten në raportin vjetor të EITI-t. Përkrah pagesave, ky raport do të paraqes informacion gjithëpërfshirës për shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe kontributin në ekonomi.

EITI në Shqipëri

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri u themelua në vitin 2009. Shqipëria u bashkua si kandidate e EITI në maj 2009 dhe fitoi statusin e plotë të anëtarësisë në maj 2013.

Proçesi në Shqipëri mbikqyret nga Grupi Ndërinstitucional i Punës ("MSG" ose "Grupi Shqiptar i Punës") i përbërë nga disa grupe interesi të EITI-t duke përfshirë Qeverinë, shoqëritë nxjerrëse, shoqëritë civile etj. Grupi Shqiptar i Punës, i cili është organi vendim-marrës dhe mbikqyrësi i zbatimit të EITI-t në Shqipëri, drejtohet nga zv. Ministri i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Sekretariati i EITI-t në Shqipëri ("AlbEITI") mbështet Grupin Shqiptar të Punës në përbushjen e detyrave të tij.

Në kuadrin e zbatimit të kësaj nisme, më 2 maj 2014, Grupi Shqiptar i Punës caktoi Deloitte si administrator të pavarur të raportit EITI në Shqipëri për vitet 2011 dhe 2012.

EITI Shqipëri ka publikuar katër raporte përkatësisht, për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012.

Ky publikim paraqet një përmbledhje të raportit të tretë dhe të katërt, që mbulojnë përkatësisht vitet 2011 dhe 2012.

Për më shumë informacion rreth kuadrin ligjor, aktivitetit të industrisë, të ardhurave që mbledh Shteti dhe procesit të raportimit referojuni raportit të plotë.

Më shumë informacion rreth EITI në Shqipëri dhe raportet EITI do të gjeni në Zyrën e AlbEITI në adresën Blv. "Zhan D'Ark", Godina nr. 3 (ish ME), kati 4, Tiranë ose në faqen e internetit www.albeiti.org.

Industria nxjerrëse në Shqipëri


Industria nxjerrëse në Shqipëri rregullohet nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë (“MEI”), e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave publike në sektorin e energjisë dhe burimeve natyrore dhe për monitorimin e zbatimit të legjislatcionit.

MEI është përgjegjëse për dhënien e licensave të kërkimit dhe shfrytëzimit (prodhimit) në sektorin e naftës, gazit dhe minierave. Më shumë informacion rreth planit të zhvillimit dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe procedurave të licënsimit do të gjeni në faqen e internetit të Ministrisë: www.energjia.gov.al.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (“AKBN”) dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (“SHGJSH”) mbështesin MEI-n në procedurat para dhe pas licënsimit, përkatësisht AKBN për licënsat e prodhimit dhe SHGJSH për licënsat e kërkimit. Procedurat para-licënsimit përfshijnë: promovimin e zonave të pashfrytëzuara, udhëzimin e operatorëve potencial mbi procesin, verifikimin teknik të planit të propozuar të prodhimit dhe negocimin e planit të investimeve dhe kushteve të tjera. Procedurat e pas-licënsimit përfshijnë monitorimin e aktivitetit të të licënsuarve përmes raportimeve periodike nga të licënsuarit dhe moniorimin në terren.

Albpetrol Sh. A. është Shoqëria e vetme e zotëruar nga Qeveria Shqiptare që vepron në zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e naftës bruto dhe e gazit. Me anë të ligjit nr. 10490, datë 15 dhjetor 2011, Kuvendi i Shqipërisë vendosi për privatizimin e Albpetrol.

Një vështrim i përgjithshëm i situatës aktuale të licënsimit dhe zonat e lira për licënsim në kërkim dhe prodhim paraqitet përkatësisht në faqen e internetit të AKBN: www.akbn.gov.al dhe në faqen e Albpetrol www.albpetrol.al për licënsat e administruara prej tij.



© Bankers Petroleum Albania Ltd

Kërkimi, zhvillimi, dhe prodhimi i naftës dhe gazit

Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi i naftës dhe gazit në Shqipëri rregullohen nga Ligji nr. 7746 “Për hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim)” datë 28 korrik 1993 (“Ligji i hidrokarbureve”). Ligji për hidrokarburet përcakton shprehimisht se të gjitha depozitat e naftës që ndodhen në gjendjen e tyre natyrore në shtresat tokësore brenda juridiksionit të Shqipërisë, janë pronë ekskluzive e Shtetit shqiptar.


Bazuar në këtë ligj Ministria e Energjisë dhe Industrisë mund të nënshkruajë Marrëveshje Hidrokarbure, të cilat i japin shoqërisë së naftës të drejta ekskluzive për të kërkuar dhe prodhuar naftë dhe gaz për një periudhë fillestare prodhimi jo më shumë se 25 vjet. Ky afat mund të zgjatet në përputhje me ligjin për hidrokarburet..

Të gjitha marrëveshjet hidrokarbure janë hartuar si Marrëveshje me Ndarje të Prodhimit (“MNP” ose “PSA”), të nënshkuara nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) si përfaqësuese e Qeverisë Shqiptare. Albpetrol, është palë në këto marrëveshje kur ato i referohen të drejtave dhe zonave për kërkim-prodhim nën administrimin e tij.

Rezervat e naftës dhe gazit¹

Kërkimi i naftës në Shqipëri filloi në vitin 1918. Që nga ajo kohë, u zbuluan fusha naftë-mbajtëse në 11 zona tokësore duke përfshirë: Drashovicën (1918), Patosin (1927), Kuçovën (1928), Marinzën (1957), Visokën (1963), Gorisht-Koçul (1965), Ballsh-Hekal (1966), Finiq-Krane (1973), Çakran-Mollaj (1977), Delvinën (1989) and Sqepurin (2001).

Bazuar në studimet e kryera nga shoqëritë e huaja dhe Albpetrol në vitet 1985-1990, rezervat e naftës në vendburimet e zbuluara në Shqipëri arrinin në rreth 437.6 milion ton, megjithatë rezervat e rekuverueshme sipas vlerësimeve të atëherëshme nuk i kalonin 81 milion ton.



Rezervat e naftës në Shqipëri përgjithësisht ndodhen në shtresat terciare në jug-perendim të Shqipërisë, kryesisht në trekëndëshin e kufizuar nga Vlora, Berati dhe Durrësi.

Rezervat në vendburimet e zbuluara të gazit natyror në Shqipëri përlogariten në 18,164 milion Nm³ dhe shtrihen kryesisht në zonën e Kuçovës dhe Patosit. Sasia kumulative e gazit të prodhuar deri në fund të vitit 2012 ishte 12,504 milion Nm³.

Figura 1 - Fushat e naftës dhe gazit në Shqipëri

Tabela më poshtë paraqet vlerësimet e rezervave gjeologjike dhe të rekuverueshme në fushat ekzistuese të naftës në milion ton:

Tabela 1 - Rezervat gjeologjike dhe të rekuverueshme të naftës në milion ton

Fushat naftë-mbajtëse	Rezervat në milion ton		Prodhimi kumulativ deri në 2012
	Gjeologjike	Rekuveruar	
Çakran –Mollaj	16.1	8.1	4.2
Ballsh-Hekal	19.7	6.5	5.1
Gorisht –Kocul	30.5	14.7	11.9
Amonice	2.8	1.5	0.7
Visoke	28.4	6.8	6.2
Delvine	0.3	0.1	-
Finiq –Krane	1	0.2	-
Drashovica	0.1	-	-
Total shkëmbinj gëlqeror	98.9	37.9	28.1
Marinëza	258.4	31.2	23.1
Kuçova	80.3	12	4.2
Total shkëmbinj ranor	338.7	43.2	27.3
Totali	437.6	81.1	55.4

Siç paraqitet më sipër, rezervat kryesore të naftës (99% e rezervave gjeologjike) ndodhen në:

- 2 zona ranore: Kuçova dhe Marinëza, të cilat së bashku përbëjnë 77% të rezervave gjeologjike dhe 53% të rezervave të rekuverueshme; dhe
- 4 zona gëlqerore: Çakran –Mollaj, Ballsh-Hekal, Gorisht –Kocul dhe Visoka, të cilat së bashku përbëjnë 22% të rezervave gjeologjike dhe 45% të rezervave të rekuverueshme.

1 - Adresa: <http://www.albpetrol.al/rezervat-gjeologjike/>

Industria nxjerrëse në Shqipëri

Në 2012, AKBN raportoi prodhimin e naftës bruto në 1,029,300 ton (2011: 894,500 ton) me një vlerë prej 484 milion USD (2011: 456.5 milion USD).

Prodhimi i naftës dhe gazit


Prodhimi i naftës në Shqipëri filloi në vitin 1929, me 750 ton naftë bruto në vit. Pas Luftës së Dytë Botërore prodhimi u rrit në mënyrë të qëndrueshme dhe arriti pikun në vitin 1974 me një prodhim prej 2.25 milion ton në vit. Në vitet '80 prodhimi i naftës ra nën 1 milion ton në vit dhe arriti përsëri në mbi 1 milion ton në vitin 2012.

Në vitin 2012, 96% e naftës bruto u prodhua nga sektori privat (2011: 93% e naftës bruto).


Ky prodhim është nxjerrë kryesisht nga fusha e Patos-Marinzës nga Bankers Petroleum, me rreth 85% e prodhimit total të naftës bruto.

Në 2012, Albpetrol raportoi se prodhimi i gazit ishte 13.1 milion Nm³, nga i cili 12.5 milion Nm³ gaz ishte gaz shoqërues i naftës (2011: prodhimi total 13.7 milion Nm³, ku 12.4 milion Nm³ ishte gaz shoqërues i naftës).

Grafiku 1- Nafta e prodhuar në vitin 2012



Grafiku 2- Nafta e prodhuar në vitin 2011



2 - Ky informacion është dërguar zyrtarisht nga Albpetrol tek AlbEITI dhe ky i fundit e prezantoi në këtë raport.

Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi në sektorin minerar

Shqipëria ka një histori të gjatë në sektorin minerar me depozita të mëdha të mineraleve të kromit, nikelit, bakrit dhe gurit gëlqeror.

Sipas Ligjit Minerar, konçensionet për shfrytëzimin minerar mund të jepen për 25 vjet, dhe janë subjekt rinovimi deri në 10 vite shtesë.

Si një vend tradicional minerar, Shqipëria ka një numër në rritje të shoqërive të vogla dhe të mesme në sektorin minerar dhe të karrierës, si dhe numëron vetëm disa shoqëri të mëdha industriale. Në Nentor 2011, AKBN raportoi 752 licenca minerare³, nga të cilat 673 licenca në prodhim, që vepronin kryesisht në rrethin e Bulqizës (136), Krujës (65), Beratit (45), Tiranës (48), Librazhdit (40) etj..

Minerali i kromit

Studimet gjeologjike tregojnë se Shqipëria ka më shumë se 36.9 milion ton³ rezerva kromi, të depozituara kryesisht në afërsi të Bulqizës, Kukësit, Hasit, Matit, dhe Pogradecit.

Figura 2 - Harta e depozitave të kromit



© Albchrome Sh.p.k.

Minerali i bakrit

Depozitat kryesore të bakrit, të vlerësuara rreth 27 milion ton³, ndodhen në qytetet veriore të Pukës, Mirditës, Kukësit, Hasit dhe Shkodrës.

Minerali i hekur-nikelit dhe nikel - silikate

Depozitat e hekur-nikelit dhe nikel-silikatit në Shqipëri vlerësohen rreth 311³ milion ton dhe ndodhen pranë Pogradecit, Librazhdit, Bilishtit, Kukësit dhe Peshkopisë.

Minerale jo-metalore

Studimet gjeologjike në Shqipëri deri në vitin 1995 tregojnë për 32 lloje të ndryshme të shkëmbinjve dhe mineraleve jometalorë industrialë duke përfshirë: shkëmbinj të gëlqeror, shkëmbinj të ranor, dolomitet, gurë dekorative karbonatikë, argjilë, granitit, gips etj. Këto minerale mund të nxirren përgjatë gjithë vendit tonë. Ato përbëjnë lëndën e parë kryesore për industrinë e ndërtimit në Shqipëri.

Depozitat e bitumit dhe asfaltit ndodhen në afërsi të Selenicës në luginën e lumit Vjosë. Shqipëria gjithashtu zotëron depozita të mëdha të kripës, në afërsi të Kavajës dhe Vlorës.

Figura 3 - Harta e depozitave të bakrit



3 - Investoni në Burimet Natyrore të Shqipërisë – Burimet Minerare, publikuar më 10 gusht 2010 nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) – www.akbn.gov.al

Industria nxjerrëse në Shqipëri

Sipas AKBN, prodhimi mineral ishte rreth 217.5 milion USD në vitin 2011 dhe 149.2 milion USD në vitin 2012. Prodhimi i kromit përbën mbi 60% të prodhimit mineral vjetor në të dy vitet.

Prodhimi i kromit

Bazuar në të dhënat e raportuara nga AKBN prodhimi i kromit në vitin 2011 dhe 2012 ishte përkatësisht 143 milion USD (66% të prodhimit total) dhe 92 milion USD (62% të prodhimit total). Ky prodhim është nxjerrë kryesisht nga minierat e Bulqizës:

- 70% të prodhimit të përgjithshëm kromit në vitin 2011, dhe
- 58% të prodhimit të përgjithshëm kromit vitin 2012.


Albchrome (ACR – më parë Albanian Chrome), i cili kryen aktivitetin në minierat e Bulqizës, ishte prodhuesi më i madh i kromit në Shqipëri me rreth 11% të prodhimit total të kromit në vitin 2011 dhe 7% në vitin 2012. Krahas Albchrome, shumë shoqëri të mesme dhe të vogla (më shumë se 200 liçensa) kanë nxjerrë krom nga Bulqizë, Tropojë, Has, Kukës, Mat etj.

Prodhimi i bakrit

Beralb ishte e vetmja shoqëri industriale në nxjerrjen e bakrit në vitin 2011 dhe 2012, me rreth 100% të vlerës së prodhimit të bakrit në të dy vitet. Beralb zotëron liçensa prodhimi për minierat e Munellës, Lak Roshit, Karmës dhe Fushë Arrës, të gjitha të vendosura në krahinën e Pukës.

Grafiku më poshtë paraqet prodhimin sipas mineraleve kryesore në USD në vitin 2011 dhe 2012:

Grafiku 3 – Prodhimi mineral në USD në vitin 2012 dhe 2011



Prodhimi i përbërjeve të nikelit

Në vitin 2011, rreth 56% të prodhimit të nikelit u raportua në Elbasan. Në vitin 2012, nikeli u prodhuan kryesisht në formën e hekur-nikelit dhe nikel-silikatit në zonën e Librazhdit 56% (2011: 17%), Pogradecit 12% (2011: 28%), Kukësit 12% (2011: asnjë) etj. Prodhimi në të dy vitet, u gjenerua nga shoqëri minerare të vogla dhe të mesme, si dhe disa të liçensuar që mblidhnin nikelin nga shoqëritë e vogla dhe të mesme.

Prodhimi i gurit gëlqeror dhe mineraleve të tjera

Një numër i madh shoqëri të vogla vepronin në nxjerrjen e gurit gëlqeror dhe materialeve të tjera të ndërtimit në vend. Fushe-Kruja Cement Factory dhe Antea Cement, me veprimtari në Krujë, ishin prodhuesit më të mëdhenj me rreth 15% dhe 12% të prodhimit total të nikelit në vitin 2012.

Kontributi në ekonominë shqiptare

AKBN raportoi prodhimin total të naftës dhe mineraleve të tjera në shumën 70.7 miliard Lek në vitin 2011 dhe 65.8 miliard Lek në vitin 2012. Nafta zinte 68% të prodhimit total në vitin 2011 dhe 76% në vitin 2012.

Sipas INSTAT, prodhimi nga industria nxjerrëse e naftës, gazit dhe mineraleve përbente rreth 4.3% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) në vitin 2011 dhe 5.6% në vitin 2012.

Në vitin 2011, eksportet nga industria nxjerrëse arritën vlerën 49 miliardë Lek, ose 25% të totalit të eksporteve. Në vitin 2012 ato u rritën në 75 miliardë Lek ose 34% e të totalit të eksporteve.


Eksportet e naftës përfaqësonin 71% të totalit të eksporteve nga industria nxjerrëse në vitin 2012 (2011: 64%).

Në vitin 2012, 53% e naftës u eksportua drejt Italisë, pasuar nga Spanja me 34%, Malta me 7% dhe Gjermania me 4%.


Eksportet nga sektori minerar në total arrijnë vlerën 21.7 miliardë Lek në vitin 2012 ose 29% të totalit të eksporteve nga industria nxjerrëse (2011: 18 miliardë lekë, 36% të totalit të eksporteve nga industria nxjerrëse).

Në vitet e fundit të kromi u eksportua kryesisht në Kinë, Hollandë, Austri, Zvicër etj. Megjithatë, Kina përfaqëson destinacionin kryesor të eksportit të kromit në vitet 2011 dhe 2012. Eksportet e bakrit kishin si destinacion kryesor Turqinë dhe Kinën.

Grafiku 4 – Prodhimi nga industria nxjerrëse



Grafiku 5 – Eksportet nga industria nxjerrëse sipas mineraleve në 2012



Kontributi i industrisë nxjerrëse në punësim mbetet modest. Sipas AKBN, shoqëritë e licënuara në nxjerrjen e naftës, gazit dhe mineraleve e tjera punësojnë së bashku më pak se 1% të totalit të të punësuarve në vend.

Kontributi në ekonominë shqiptare

Të ardhurat e Qeverisë nga sektori i naftës, gazit dhe sektori minerar

Shteti shqiptar merr pjesën e tij nga vlera e krijuar nga industria nxjerrëse nëpërmjet:

- Tatimit të veprimtarisë hidrokarbure dhe minerare
- Taksave / tarifave dhe
- Dividendëve nga pronësia në Albpetrol Sh.a.

Lloji kryesor i të ardhurave që lidhen drejtpërdrejtë me sektorin nxjerrës paraqitet si më poshtë:

Renta minerare paguhet për shfrytëzimin e burimeve natyrore, në bazë të ligjit "Për taksat kombëtare" nr. 9975, datë 28 korrik 2008, i ndryshuar. Renta minerare për eksportet mblidhet nga Administrata Doganore Shqiptare dhe renta minerare nga shitjet brenda vendit mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Sipas ligjit për taksat kombëtare, renta minerare nga shitja e naftës dhe gazit përlogaritet në 10% e vlerës së tatueshme, ndërsa për mineralet e tjera renta varion nga 4% në 7%.

Bonuset e nënshkrimit dhe trajnimit janë terma pagese tipike të marrëveshjeve hidrokarbure. Ato përcaktohen (sipas negociatave të marrëveshjes) në momentin e dhënien së lejes të kërkimit ose prodhimit të naftës dhe gazit sipas termave dhe kushteve specifike të kontratës.

Bonuset e nënshkrimit mblidhen nga Albpetrol (për nënshkrimin e liçensave të prodhimit) dhe AKBN (për nënshkrimin e lejeve të kërkimit).

Tatimi mbi fitimin mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si përqindje mbi fitimin e tatueshëm të shoqërisë. Deri në dhjetor 2013, tatimi mbi fitimin në Shqipëri përlogaritej me 10% e fitimit të tatueshëm në përputhje me "Ligjin për tatimin mbi të ardhurat" Nr. 8438, datë 28 Dhjetor 1998, ndryshuar. Më 1 Janar 2014, norma e aplikushme e tatimit mbi fitimin u rrit në 15%. Kërkesat e këtij ligji janë plotësisht të zbatueshme për sektorin minerar.

Tatimi mbi fitimin në sektorin hidrokarbur përlogaritet në 50% mbi fitimin e tatueshëm sipas Dekreti nr. 782 "Mbi sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve", datë 22 dhjetor 1994 ("Ligji për tatimin e naftës"). Sipas këtij ligji, në përlogaritjen e fitimit të tatueshëm merren parasysh të ardhurat dhe shpenzimet operative dhe kapitale të akumuluar siç përcaktohet në marrëveshjen hidrokarbure.

Ndarja e prodhimit të naftës - Albpetroli zotëron pjesë nga nafta e prodhuar nga liçensë-marrëveshjet nën administrimin e tij. Si rrjedhojë, Albpetroli ka të drejtë të përfitojë pjesë nga ndarja e prodhimit për prodhimin ekzistues dhe prodhimin e nxjerrë nga shoqëria e liçensuar, siç përcaktohet në marrëveshjen hidrokarbure. Ndarja nga prodhimi mund të paguhet në para ose në natyrë.

Në përputhje me marrëveshjen hidrokarbure, shoqëritë duhet t'i kalojnë Albpetrolit prodhimin ekzistues në masën 65 deri në 75% dhe pjesë nga prodhimi vetjak në masën 1 deri në 5%.

Albpetroli është gjithashtu subjekt i tatimit dhe taksave të aplikueshme për shoqëritë tregtare të naftës si tatimi mbi fitimin, renta minerare, TVSH etj. Shteti, në cilësinë e aksioner, ka të drejtë të përfitojë dividendët dhe të ardhurat nga privatizimi i Albpetrol.


Të ardhurat e gjeneruara nga industria nxjerrëse nga ndarja e prodhimit të naftës, renta minerare, tatimi mbi fitimin dhe bonuset e nënshkrimit janë në total 11.86 miliardë Lek (2011: 9.32 miliardë Lek). Këto të ardhura përfshijnë prodhimin e naftës dhe bonuset në vlerën 5.41 miliardë Lek të mbledhur nga Albpetrol për licensat e prodhimit nën administrimin e tij (2011: 3.56 miliardë Lek). Albpetrol, si shoqëri e licensuar, derdhi në Buxhetin e Shtetit rentën minerare, tatimin mbi fitimin dhe dividendin në shumën 1.9 miliardë Lek në total (2011: 0.75 miliardë Lek). Pagesat në shumën 8.35 miliardë Lek ose 70% e flukseve totale të pagesave nga industria nxjerrëse, janë regjistruar në Buxhetin e Shtetit (2011: 6.5 miliardë Lek ose 70%)

Pagesat nga industria nxjerrëse kontribuan me 2.5% në totalin e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit në vitin 2012 (2011: 1.8%).

Sektori privat i naftës dhe gazit gjeneroi pjesën më të madhe të kontributit në Buxhetin e Shtetit në vlerën 5.18 miliardë Lek ose 62% e pagesave ndaj Buxhetit të Shtetit nga industria nxjerrëse (2011: 3.97 miliardë Lek ose 62%). Albpetrol dhe sektori minerar gjeneruan përkatësisht 23% dhe 15% të këtij kontributi (2011: 11% dhe 28%).

Në vitin 2012, pagesat e kryera ndaj Albpetrol nga shoqëritë e naftës dhe gazit në përputhje me marrëveshjet hidrokarbure ishin 5.41 miliardë Lek (2011: 3.56 miliardë Lek). Nëse këto pagesa do të ishin regjistruar direkt në Buxhetin e Shtetit, kontributi i industrisë nxjerrëse në Buxhet do të ishte përkatësisht 4.1% në vitin 2012 dhe 2.9% në vitin 2011.

Figura 5 – Analiza e pagesave gjeneruar nga industria nxjerrëse në vitin 2012



Sipas ligjit për taksat kombëtare në fuqi në vitet 2011 dhe 2012, 25% e rentës minerare të arkëtuar duhet të transferohej tek Njësia e Qeverisjes Vendore (NjQV-ve) nga ku është nxjerrë prodhimi minerar.

Ministria e Financave raportoi se nuk është bërë asnjë transferim rente drejt NjQV-ve gjatë vitit 2011. Në vitin 2012, transferimet për rentën minerare arritën shumën 41.7 milion Lek që përbën 0.6% të rentës së mbledhur në total.

Sipas Ministrisë së Financave, të ardhurat nga renta minerare në vitin 2011 dhe 2012 ishin regjistruar në buxhetin e Shtetit në grup dhe nuk janë mbajtur regjistrime të sakta mbi rentën e gjeneruar nga secila NjQV.

Figura në të majtë paraqet një pamje të përgjithshme të pagesave gjeneruar nga industria nxjerrëse dhe shpërndarjen e tyre ndërmjet Buxhetit të Shtetit dhe shoqërisë Albpetrol.

Rakordimi i të ardhurave dhe pagesave

Përzgjedhja e shoqërive raportuese për vitet 2011 dhe 2012

Të gjitha shoqëritë që operonin një licensë në kërkim-zbulim për naftën, gazin dhe mineralet dhe një licensë prodhimi në naftë dhe gaz, u përzgjedhën të raportonin pagesat sipas Standartit EITI. Kështu, fluksi i parasë së rakorduar për sektorin e naftës dhe gazit përfaqëson 100% të fluksit të parasë kontribuar në total nga ky sektor për llojet të ardhurave përfshirë në këtë rakordim.

Për shkak të numrit të madh të shoqërive prodhuese me shkallë të vogël aktiviteti, në sektorin minerar u aplikuan kritere të caktuara materialiteti ndaj xhiros dhe prodhimit vjetor me qëllim përzgjedhjen e prodhuesve më të mëdhenj. Përzgjedhja rezultoi me:

- 58 shoqëri minerare në vitin 2011, (71.4% të vlerës së prodhimit)
- 69 shoqëri minerare në vitin 2012, (77.1% të vlerës së prodhimit)

Numri total i të licensuarve të përzgjedhur për procesin e rakordimit:

- në vitin 2011 ishte 67 gjithësej dhe përfshinte 8 shoqëri naftë, Albpetrol dhe 58 shoqëri minerare
- në vitin 2012 ishte 78 gjithësej dhe përfshinte 8 shoqëri naftë, Albpetrol dhe 69 shoqëri minerare.

Krahasimi i pagesave me të ardhurat rezultoi me disa mospërputhje. Pjesa më e madhe e mospërputhjeve u shpjegua nëpërmjet punës së rakordimit. Mospërputhjet e shpjeguara rezultuan kryesisht për shkak të shumave të paraportuara fillimisht ose gabimeve në raportim.

Deri në datën e këtij Raporti flukset e parasë u rakorduan në 99% e flukseve të raportuara nga të licensuarit dhe Shteti ose të licensuarit dhe Albpetrol në të dy vitet.

Tabela 2 Përmbledhja e rakordimit të pagesave ndaj Buxhetit të Shtetit në vitet 2011 dhe 2012

Pagesat e agreguara	Shuma e korigjuar në <i>million Lek</i> për vitin 2012			Shuma e korigjuar në <i>million Lek</i> për vitin 2011		
	Të licensuarit	Qeveria	Mospërputhja	Të licensuarit	Qeveria	Mospërputhja
Spektori i naftës dhe gazit	5,834	5,834	-	3,966	3,966	-
Spektori minerar	1,008	989	19	932	917	15
Albpetrol	1,889	1,901	(12)	760	741	19
Totali	8,731	8,724	7	5,659	5,625	34

Tabela 3 Përmbledhja e rakordimit të pagesave ndaj Albpetrol për ndarjen e prodhimit të naftës dhe bonuset sipas marrëveshje në vitet 2011 dhe 2012

Pagesat e agreguara	Shuma e korigjuar në <i>million Lek</i> për vitin 2012			Shuma e korigjuar në <i>million Lek</i> për vitin 2011		
	Të licensuarit	Albpetrol	Mospërputhja	Të licensuarit	Albpetrol	Mospërputhja
Spektori i naftës dhe gazit	5,478	5,415	63	3,546	3,558	(12)
Totali	5,478	5,415	63	3,546	3,558	(12)

Rakordimi i pagesave përmbledhëse në Buxhetin e Shtetit nga sektori i naftës dhe i gazit

Renta minerare është fluksi më i madh i parasë paguar nga sektori i naftës dhe i gazit në Buxhetin e Shtetit. Ky fluks zë përkatësisht 79% dhe 87% të pagesave totale të raportuara nga sektori i naftës dhe gazit në vitet 2011 dhe 2012.

Asnjë Shoqëri e naftës dhe gazit nuk rezultoi me fitim të tatuëshëm dhe pagesa për tatimin mbi fitimin në vitet 2011 dhe 2012.

Bankers Petroleum Albania ka kontributin më të madh në flukset e parasë të derdhura në Buxhetin e Shtetit me mbi 90% të flukseve paguar nga sektori privat i naftës dhe gazit në vitet 2011 dhe 2012.

Rakordimi i pagesave përmbledhëse në Buxhetin e Shtetit nga sektori minerar

Tatimi mbi fitimin dhe renta minerare përbëjnë flukset kryesore të gjeneruar nga sektori privat minerar, përkatësisht 64% dhe 27% të pagesave të raportuara nga sektori minerar në vitin 2011 dhe 55% dhe 43% të pagesave të raportuara në vitin 2012.

Kontributi nga dy prodhuesit më të mëdhenj të kromit dhe të bakrit në vitin 2011 përbënte 54.4% e pagesave të raportuara nga sektori minerar. Këto dy shoqëri ishin përkatësisht Beralb (bakër) me kontribut prej 292,389 mijë Lek ose 31% dhe Albchrome (krom) me kontribut prej 220,883 mijë Lek ose 23.4%.

Në vitin 2012, ky kontribut ishte 53% e pagesave të raportuara nga sektori minerar. Pagesat nga Beralb ishin në vlerën 464,092 mijë Lek ose 46% e flukseve totale të parasë së raportuar nga sektori minerar. Albchrome kontriboi me 65,429 mijë Lek ose 7% të flukseve totale.

Tabela 4 - Përmbledhja e pagesave nga sektori i naftës dhe të gazit në Buxhetin e Shtetit – sipas llojit të të ardhurave

Lloji i të ardhurave	Shuma e korigjuar në <i>million Lek</i> për vitin 2012			Shuma e korigjuar në <i>million Lek</i> për vitin 2011		
	Të liçensuarit	Qeveria	Mospërputhja	Të liçensuarit	Qeveria	Mospërputhja
Renta minerare - në eksport	5,104	5,104	-	3,128	3,128	-
Renta minerare - shitjet brenda vendit	125	125	-	724	724	-
Penaltitet	215	215	-	<i>Nuk ishin subjekt rakordimi në 2011</i>		
Bonuset e nënshkrimit	390	390	-	114	114	-
Totali	5,834	5,834	-	3,966	3,966	-

Tabela 5 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori minerar në Buxhetin e Shtetit – sipas llojit të të ardhurave

Lloji i të ardhurave	Shuma e korigjuar në <i>million Lek</i> për vitin 2012			Shuma e korigjuar në <i>million Lek</i> për vitin 2011		
	Të liçensuarit	Qeveria	Mospërputhja	Të liçensuarit	Qeveria	Mospërputhja
Tatimi mbi fitimin	549	528	21	601	591	10
Renta minerare - në eksport	341	344	(3)	255	250	5
Renta minerare - shitjet brenda vendit	99	99	-	56	56	-
Penaltitet	8	6	2	<i>Nuk ishin subjekt rakordimi në 2011</i>		
Taksa e siperfaqes	<i>Shfuqizuar me ligjin e ri minerar</i>			4	4	-
Tatimi mbi dividendin	11	12	(1)	16	16	-
Totali	1,008	989	19	932	917	15

Deloitte kryen shërbime këshillimi për auditin, taksat dhe financat për klientë publikë dhe privatë që kapin një shtrirje të gjerë industriale. Me një rrjet që lidh globalisht anëtarët e firmave në 150 vende, Deloitte sjell aftësi të një rangu botëror dhe ekspertizë të thelluar lokale që të ndihmojë klientët e vet t'ia dalin kudo ku veprojnë. 210 000 punonjësit profesionistë të Deloitte janë të përkushtuar për t'u shndërruar në standard të ekselencës.

Punonjësit profesionistë të Deloitte i përbashkon kultura e bashkëpunimit që ushqen integritetin - vlerë e jashtëzakonshme për tregun dhe klientët, përkushtimin ndaj njëri-tjetrit, si dhe forcën si pasojë e diversitetit. Ata shijojnë frytet e një mësimi të vazhdueshëm, përvojave sfiduese dhe mundësive të shumta për të bërë karrierë. Punonjësit profesionistë të Deloitte janë të përkushtuar në forcimin e përgjegjësisë së korporatës, ndërtimin e besimit publik, si dhe në krijimin e një ndikimi pozitiv në komunitetet e tyre.

Deloitte i referohet një ose më shumë se një Deloitte Touche Tohmatsu Limited, një kompani private në Mbretërinë e Bashkuar me garanci të kufizuar, si dhe rrjetit të saj të firmave anëtare, secila prej të cilave është një entitet ligjorisht i ndarë dhe i pavarur. Ju lutemi, lexoni në www.deloitte.com/al/about për një përshkrim më të hollësishëm të strukturës ligjore të Touche Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare.